



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 01.07.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rehabilitimi i Rrugëve Dytësore në Zonën e Durrësit të Ri”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

137,604,971.55 (njëqind e tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Durrës 2026.

Argumentimi:

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.132, datë 10/04/2026, me Nr.4834 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t`u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit, dokumentet sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondin limit, shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuara nga grupi i punës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.132, datë 10/04/2026, me Nr.4834 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 137,604,971.55 (njëqind e tridhjetë e shtatë milion e gjashëqind e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 7. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata “Rehabilitimi i Rrugeve Dytesore në Zonën e Durrësit të Ri”. Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar

vijimësinë e punimeve. Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohej që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit. Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së rehabilitimit të rrugëve dytesore në zonën e Durrësit të Ri, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Ky kriter është ligjërish i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare

dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve të rehabilitimit të rrugëve dytesore në zonën e Durrësit të Ri.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si vijon: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale të tjera, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.132, datë 10/04/2026, me Nr.4834 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP - 1 A Punime gjërmimi në tokë.
- NP - 2 B Ndërtime civile dhe industrial.

- NP - 4 C *Rruge, autostrada mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.*
- NP - 7 B *Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.*
- NP - 12 A *Punime të inxhinierisë së mjedisit.*
- NS - 1 A *Punime për prishjen e ndertimeve.*
- NS - 6 A *Sinjalistika rrugore jondriçuese*
- NS - 14 A *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV*
- NS - 18 A *Punime topogjeodezike.*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Kategoritë e licensave janë vendosur në përputhje me zërat e preventivit konkretisht punime KUZ, punime Sistemimi dhe punime Sinjalistike.*

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përlllogaritur të kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria ekërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera
NP-1A	Punime gërmimi në tokë.	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet	0-20 mln leke	2,043,249.24 Lek

NP-2B	Ndërtime civile dhe industriale	Themel betoni C16/20 Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20 F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	21-50 mln leke	21,666,117.75 Lek
NP-4C	Rruge, autostrada mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese stabilizant t=10cm Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese betoni C 16/20 Shtrese rere Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka F.V. Bordura betoni 15x30cm Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	51-100 mln leke	66,415,379.80 Lek
NP-7B	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi evaditje	F.V. Pusete 40x60x150 cm, me kapak zgare gize F.V. Pusete betoni me kapak gize dhe gjithë aksesoret 80x80x80 Mbingritje h=0.5 m, Pusete ekzistuese UZ Ø 1.0 m F.V. Tuba celiku Ø>200 te pa izoluar per ujesjellsa te jashtem F.V. Tuba PVC Ø 400 mm per linja te jashtme F.V. Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar F.V. Tuba PVC Ø 250 mm per linja te jashtme F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm Spostime linja ujesjellesi te brinjezuar HDPE (perfshire heqjen e tubit ekzistues, germim, prerje tubi, montim, aksesore etj) Monitorim i rrjetit te kanalizimeveme CCTV (kamera inspektimi)	0-20 mln leke	35,370,235.45 Lek

		Shpim mikrotuneli ne drejtim horizontal (HDD)> D250mm Pastrim tubacioni kanalizimesh me presion		
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Transport dheu me auto deri 5.0 km, Pastrim tubacioni kanalizimesh me presion	0-20 mln leke	1,590,196.32 Lek
NS-1A	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje shtresa betoni Prishje trotuari ekzistues Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.	0-20 mln leke	239,604.20 Lek
NS-6A	Sinjalistika rrugore jondriçuese	F.V. Tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm, Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Akrelike, F.V. Sinjale "emër rruge" LxH e vogël 60x20	0-20 mln leke	2,371,178.80 Lek
NS-14-A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV	F.V. Tuba plastmasi ø 80, F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm, Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)	0-20 mln leke	3,901,098.19 Lek
N.S-18A	Punime topogjeodezike.	Punime topografike të ndryshme .	0-20 mln leke	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- b. Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- c. Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- d. Inxhinier Mekanik 1 (një)
- e. Inxhinier Elektrik 1 (një)

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.

- Të paraqitet listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë .
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr.42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e

Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

- Inxhinieri i Ndërtimit është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve me qëllim realizimin saktë të zerave të parashikuar në projekt si punime.
- Inxhinieri Hidroteknik është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve KUB të parashikuar në projekt.
- Inxhinieri Gjeodet është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve KUB në rilevimin e terrenit të parashikuar në projekt.
- Inxhinieri i Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve elektromekanike të parashikuara në projekt.
- Inxhinieri i Elektrik është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve elektrike të parashikuara në projekt.
- Inxhinieri i Mjedisit është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve mjedisore të parashikuara në projekt.

Shënim: Bazuar në Rekomandimin Nr.6732, datë 21.10.2020 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”, inxhinierët e mësipërm duhet të vetdeklarojnë se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë/certifikatë përkatëse, konkretisht:

- 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë

18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësin e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" bazuar në përlogaritjen e oreve të punës, kategorite të punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve, të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK, si edhe bazuar në dosmosdoshmerinë e realizimit sa më shpejt të objektit.

- *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këto kontrate ku dhe numuri i punojësve të kërkuar për realizimin e saj është i lartë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: "Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes."

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më

poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- Teknik Ndërtimi	1(një)
- Hidraulikë	1(një)
- Karpentier	2 (dy)
- Betonues	1(një)
- Hekurkthyes	2 (dy)
- Shofer	2 (dy)
- Punëtorë ndërtimi të thjeshtë	10 (dhjetë)

Punonjes Manovrator

- Eskavatorist	2 (dy)
- Manovrator/automakinist	2 (dy)

Për stafin teknik dhe punonjësit e specializuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune të vlefshme;
- Diplomë profesionale, certifikatë ose dokument tjetër që provon kualifikimin profesional, lëshuar nga institucione të licencuara sipas legjislacionit në fuqi ose ekuivalente;
- Certifikatë të sigurimit teknik, të lëshuar nga subjekte të akredituara nga DPA ose organizma ekuivalentë ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, kur kërkohet sipas profilit të punës.

Për punonjësit shoferë duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Leje drejtimi e vlefshme;
- Certifikatë e aftësisë profesionale ose patentë manovrimi e lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur shoferët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për manovratorët/automakinistët duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Dëshmi aftësie profesionale për përdorimin e makinerive të rënda, sipas legjislacionit në fuqi dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Në rastin kur manovratorët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për punëtorët e thjeshtë të ndërtimit duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin dhe paraqitjen e formularit të vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet

nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

- Karpiertieret dhe hekurthyesit janë të nevojshëm për punimet e armaturave të hekurit.

- Manovratorët janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda si eskavatori, rruli, autovinc etj
- Drejtesit e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere.
- Hidraulikët janë të nevojshëm për të garantuar instalimin e sistemeve të kanalizimit të ujërave të ndotura, përfshirë montimin e tubacioneve, kontrollin e pompave, dhe sigurinë e rrjedhës së ujit.
- Teknik i ndërtimit është i nevojshëm për të monitoruar dhe udhëhequr punimet në terren, duke siguruar që të gjitha fazat e ndërtimit të bëhen sipas projektit dhe standardeve teknike. Ata gjithashtu menaxhojnë koordinimin midis ekipeve të ndryshme dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve teknike gjatë procesit të ndërtimit.
- Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin e rrjetit të kanalizimit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkëlidhur deklaratës për Drejtesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 23 persona, në listpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ë fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve prej 23 punonjës përfshin punëtorë të thjeshtë, stafi i kualifikuar inxhinierëve, person teknikë, person specializuar/të kualifikuar. Ky numër është

llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë. Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur ne baze te volumeve te punës dhe grafikut te punimeve.

Referuar VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/makinerive/pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Eskavator me zinxhir 7 deri në 8.5 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
2	Minieskavator me zinxhir gome min 3.5 deri në 6.5 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
3	Minieskavator me zinxhir gome min ton 1.5 ton deri në 2.5ton	Pronësi ose me qira	1 cope
4	Fadrome me goma kove para-mbrapa (mjet teknologjik)	Pronësi ose me qira	1 cope
5	Mini fadrome (bobcad)	Pronësi ose me qira	1 cope
6	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	Pronësi ose me qira	3 cope
7	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10 deri në 18 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
8	Kamiocine kapacitet 3.5 deri në 5 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
9	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton, për transport të përzier	Pronësi ose me qira	2 cope
10	Kamion me vinxh me kapacitet 5 deri në 10 ton	Pronësi ose me qira	2 cope
11	Damper kantieri	Pronësi ose me qira	2 cope
12	Autobot Uji min 5000 liter	Pronësi ose me qira	1 cope
13	Makineri për punë në hapsira të vogla, me gjerësi deri në 10cm me 100 cm, të pajisur me lopatë të përparme.	Pronësi ose me qira	1 cope
14	Makineri germimi dhe ngjeshjeje, për punë në hapsira të ngushta, me gjerësi deri në 15cm me 90 cm.	Pronësi ose me qira	1 cope
15	Motokarroc me zinxhir, të pajisur me pirun ngritës të përparmë për transportin e ngarkesave të rënda, e pajisur me kontenier hidraulik me kapacitet të ngarkimit 600 kg.	Pronësi ose me qira	1 cope
16	Grejder (mjet teknologjik)	Pronësi ose me qira	1 cope
17	Rrule gjeshës gome-hekur	Pronësi ose me qira	1 cope
18	Rrule gjeshës hekur- hekur	Pronësi ose me qira	1 cope
19	Autobitumatrice	Pronësi ose me qira	1 cope
20	Asfaltoshtruese te vogel	Pronësi ose me qira	1 cope
21	Freze asfalti	Pronësi ose me qira	1 cope
22	Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit	Pronësi ose me qira	1 cope
23	Motogjenerator	Pronësi ose me qira	1 copë

24	Kompresor	Pronësi ose me qira	1 copë
25	Matrapik	Pronësi ose me qira	1 copë
26	Vibrator betoni	Pronësi ose me qira	2 copë
27	Sistem makineri e drejtuar me lazer per realizimin e miktotuleli me diameter 100÷300mm	Pronësi ose me qira	1 cope
28	Sonde per pastrimin e tubacioneve te ujerave te ndotura me kapacitet pompe mbi 200 bar	Pronësi ose me qira	1 cope
29	Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton.	Pronësi ose me qira	1 cope
30	Dedektor rrjetesh nentoksore me GPRS	Pronësi ose me qira	1 cope
31	Helikopter per nivelim betoni	Pronësi ose me qira	1 cope
32	Paisje per monitorim të rrjetit të kanalizimeve me CCTV	Pronësi ose me qira	1 cope
33	Betoniere kantieri 0.25 deri në 0.5 m3	Pronësi ose me qira	1 copë
34	Autobetoniere kantieri me kapacitet mbajtes deri 2.5m3	Pronësi ose me qira	2 copë
35	Autobetoniere	Pronësi ose me qira	2 cope
36	Autopompë betoni	Pronësi ose me qira	1 cope
37	Fabrikë Betoni	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi	1 cope
38	Sperkates boje per vijezim	Pronësi ose me qira	2 cope
39	Paisje topografike Totalstation/GPS	Pronësi ose me qira	1 cope
40	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	Pronësi ose me qira	1 cope
41	Rimorkiator per levizjen e makinerive te ndertimit me kapacitet mbajtese jo me pak se 20 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
42	Semafore	Pronësi ose me qira	5 cope

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet te paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.

- Për mjetet e marra me qira që shënohen në regjistra publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Kurse për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për të gjithë mjetet dhe pajisjet e kërkuara të shoqërohen me foto.

Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatat të vlefshme si më poshtë:

- A.** Certifikatë: ISO 9001/2015 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- B.** Certifikatë: ISO 45001 : 2018 - Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- C.** Certifikatë: ISO 14001:2015-“Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente.

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.4.1 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 45001-2018 Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar që ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatorë për mbrojtjen e mjedisit. Kjo certifikatë siguron që kompania ndërtuese ka implementuar praktika dhe sisteme për të menaxhuar ndikimet mjedisore të punimeve, si ndotja e ajrit, ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara sipas pikës 2.4.1 germa “A”- “C”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjesëtim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.4.2 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqes grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”*

Grupi i hartimit të specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qenë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në mbështetje të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me natyrën dhe kërkesat funksionale të objektit “Rehabilitim i rrugëve dytësore në zonën e Durrësit të Ri”, duke garantuar konkurrencë të barabartë, trajtim të paanshëm dhe përdorim eficient të fondeve publike. Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit dhe përcaktojnë standardet minimale të cilësisë, metodologjinë e zbatimit dhe kërkesat për materialet, makineritë dhe kontrollin teknik të punimeve. Nga ana teknike, specifikimet janë hartuar mbi bazën e standardit ndërkombëtar CESMM4 për matjen dhe klasifikimin e punimeve civile, duke siguruar përshkrim të qartë të volumeve të punës, metodave të zbatimit dhe kriterëve të matjes. Dokumentacioni teknik përfshin punime prishjeje, gërmime, shtresa rrugore, asfaltobeton, drenazhime, rrjete ujësjellësi e kanalizimesh, si dhe punime elektrike, të cilat janë parashikuar të realizohen sipas kushteve teknike të zbatimit dhe standardeve përkatëse të ndërtimit. Gjithashtu, specifikimet teknike parashikojnë detyrimin e kontraktorit për të garantuar cilësinë e materialeve dhe punimeve nëpërmjet testimeve, mostrave, certifikatave të cilësisë dhe kontrollit nga mbikëqyrësi i punimeve. Çdo punim që nuk përputhet me kërkesat teknike apo projektin do të

refuzohet dhe do të riparohet me shpenzimet e kontraktorit. Këto kërkesa synojnë garantimin e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe funksionalitetit afatgjatë të investimit publik.

Shenim: Në çdo kerkese te preventivit ku eshte shenuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit